

KONTRATE
PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE "MEDIA 6" SH



Personat e meposhtem:

1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja "Beslidhja", Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935;
2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue "Mozart", me pasaporte nr.03/97;
3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen "Fadil Rada", Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026

te quajtur me poshte "ortake", rane dakord te krijojne nje shoqeri tregtare te se Drejtes Shqiptare, ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", duke percaktuar kushtet e meposhtme:

Neni 1. Forma dhe emertimi

Shoqeria e sapo krijuar eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe emertohet "Media 6" Sh.p.k.

Neni 2. Selia e shoqerise:

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne Rrugen "Myslym Shyri" N. 8/1. Ajo mund te transferohet ne nje vend tjetër me vendim te shumices absolute te Asamblese se Ortakeve.

Neni 3. Kohezgjatja:

Aktiviteti i kesaj shoqerie do te zgjase per nje periudhe kohe prej 10 vjetesh. Ortaket mund ta zgjasin kete afat ose mund te vendosin qe ta prishin shoqerine perpara ketij afati.

Neni 4. Statusi

Shoqeria fiton statusin e personalite juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar. Ajo eshte person juridik i se Drejtes Shqiptare dhe keshtu veprimtaria e saj rregullohet nga Legjislacioni Shqiptar, nga kjo Kontrate Themelimi dhe nga Statuti i nenshkruar rregulisht nga ortaket themelues.

Neni 5. Objekti i veprimtarise:

Shoqeria do te kryeje veprimtari botuese revistash, gazetash, librash, tregetim te tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar KLAN, import-eksport mallrash e materialesh qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares e tregetes te botimeve te mesiperme, aktivitet ne fushen e

Aleksander Frangaj
Marsel Skendo

mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne keto lloj veprimtarish.

Shoqeria rezervon te drejten te modifikojte objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe ne menyren e percaktuar ne kete statut.

Neni 6. Kapitali themeltar:

Kapitali themeltar i shoqerise caktohet ne shumen 100000 leke dhe nenshkruhet nga te tre ortaket dhe depozitohet prane nje noteri.

Kapitali themeltar ndahet ne 100 pjese te barabarta me vlere nominale 1000 leke secila.

Kontributet e ortakeve ne kapitalin themeltar jane perkatesisht:

- | | | |
|----|---------------------------|--------------------|
| 1. | Ortaku Julien Roche | 25 pjese (25%) |
| 2. | Ortaku Marsel Skendo | 25 pjese (25%) dhe |
| 3. | Ortaku Aleksander Frangaj | 50 pjese (50%) |

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve qe merr miratimin e 3/4 te ortakeve.

Zvogelimi nen shumen e kapitalit themeltar detyron ortaket qe te marrin vendim edhe per shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter.

Zvogelimi i kapitalit pas rritjeve te tij, brenda kufijve te pranuar nga ligji, kushtezon edhe riorganizimin e pjeseve te kapitalit dhe masen e kontributeve te secilit ortak.

Ne rast zmadhimi te kapitalit, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7. Transferimi i pjeseve:

7.01 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rruge trashegimie.

7.02 Pjeset e kapitalit themeltar mund t'i transferohen nje personi te trete qe nuk ben pjese ne shoqeri vetem pasi te jete aplikuar opcioni I parablerjes nga ortaket e shoqerise.

Neni 8. Ndarja e fitimit

Fitimi i realizuar nga shoqeria, mbas heqjes se shpenzimeve, pagesave te ndryshme, taksave e tatimeve, ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me shkallen e pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 9. Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve.

Ortaket kane keto te drejta kryesore:

Aleksander Frangaj
Frangaj

- te ndihmojne shoqerine ne aktivitetin drejtues dhe organizativ ne perputhje me Statutin dhe Kontraten e Themelimit.
- te bejne propozime dhe t'ia paraqesin ato per shqyrtim Asamblese se Ortakeve.
- te kerkojne te dhena e raporte nga organet e shoqerise per ecurine financiare dhe ekonomike te saj.
- Te marrin pjese ne ndarjen e fitimeve te shoqerise.

Ortaket kane keto detyrime kryesore:

- te shlyejne pjesete e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise ne perputhje me kontraten e themelimit.
- te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve dhe te zbatojne vendimet e marra nga ajo ne perputhje me dispozitat e Statutit.
- te ndihmojne shoqerine ne drejtim te sigurimit te kushteve per funksionimin dhe aktivitetin e saj.
- te ruajne sekretin per te dhenat e shoqerise.

Neni 10. Administrimi i shoqerise:

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator, i cili emerohet per nje afat njevjecar. Emerimi behet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me dispozitat e Statutit.

Administrator i pare i shoqerise eshte Ortaku Aleksander Frangaj.

Administratori ushtron te drejttat dhe kryen detyrat qe percakton neni 50 i ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe Statuti bashkelidhur.

Neni 11. Asamblea e Ortakeve:

Asamblea e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise.

Ortaket marrin pjese ne Asamblene e Ortakeve te shoqerise e cila mblidhet ne mbledhje te zakonshme ose te jashtezakonshme per te marre vendime per ceshtjet me te rendesishme qe i perkasin shoqerise sic percaktohen ne Statutin bashkelidhur.

Mbledhjet e zakonshme behen te pakten nje here ne vit. Ortaket marrin pjese ne vendimet e Asamblese duke disponuar nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe zoteron sejcili.

Menyra e funksionimit, detyrat dhe te drejttat, procedurat dhe organizimi qe ka Asamblea percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

Neni 12. Te ndryshme

Mosmarreveshjet mes ortakeve qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

ORTAKET THEMELUES

Aleksander Frangaj

Mareel Skendij

Frangaj

Skendij



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 1494 REP.
NR. 433 KOL.

V E R T E T I M

Sot, me date 11 shkurt 1997, para meje noteres Mimoza Sadushi u paraqit personalisht 1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja "Beslidhja", Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935; 2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue "Mozart", me pasaporte nr.03/97; 3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen "Fadil Rada", Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026 "Per Shogerite Tregtare". Pasi u binda per identitetin e tij nepermjet verifikimit te dokumenteve personale te identifikimit, vertetoj nenshkrimin e tij ne perputhje me kerkesat e ligjit.

MIMOZA SADUSHI
NOTERE
sa: Pallatet e Lanës, 1
e Fax - 355 42 23066
TIRANE TIRANE



Mimoza Sadushi

STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE "MEDIA 6" Sh.p.k.



Ortaket themelues te shoqerise ''MEDIA 6'' sh.p.k.

1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja ''Beslidhja'', Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935
2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue ''Mozart'', me pasaporte nr.03/97
3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen ''Fadil Rada'', Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026

nenshkruajne statutin e shoqerise i cili rregullon funksionimin e shoqerise nepermjet dispozitave te meposhtme:

Neni 1. Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte "MEDIA 6" Sh.p.k., qe me poshte do te quhet "shoqeria".

Ky emertim duhet te pasqyrohet ne te gjithë dokumentacionin e brendshem te shoqerise si dhe ne korrespondencen me te tretet.

Emertimi i saj do te pasohet menjehere nga fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose shkurt Sh.p.k., nga numri i regjistrimit te saj, emri i administratorit dhe selia.

Neni 2. Forma juridike e shoqerise

Shoqeria tregtare "Media 6" Sh.p.k. eshte person juridik shqiptar i formes juridike me pergjegjesi te kufizuar dhe funksionon ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar ne teresi e te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te Kontrates se Themelimit dhe Statutit te saj, ne vecanti.

Neni 3. Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Tirane ne Rrugen "Myslim Shyri", Nr. 8/1.

Asamblea e Ortakeve, me shumice absolute votash, mund ta transferoje seline ne nje vend tjeter.

Neni 4. Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar per 10 vjet. Ky afat mund te shtyhet me tej ose te shkurtohet me vendim te ortakeve sipas dispozitave te ketij Statuti.

Neni 5. Statusi

Shoqeria fiton statusin e personit juridik nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit te Tiranes.

Ajo ne cdo rast pergjigjet vetem me pasurine e saj ndersa ortakët nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise dhe per humbjet qe mund t'i ndodhin asaj tej pjeseve te kapitalit qe ata kane shlyer ne kapitalin themeltar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6. Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kryeje veprimtari botuese revistash, gazetash, librash, tregetim te tyre, ne menyre te vecante duke filluar me botimin e revistes se emertuar KLAN, import-eksport mallrash e materialesh qe i sherbejne aktivitetit prodhues, shperndares e tregetes te botimeve te mesiperme, aktivitet ne fushen e mediave elektronike ne baze te dispozitave ligjore qe do te rregullojne

Shoqeria rezervon te drejten te modifikoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe ne menyren e percaktuar ne kete statut.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 7. Kapitali fillestar

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100000leke(njegindmije) dhe ndahet ne 100(njegind) pjese te barabarta me vlere nominale 1000leke secila.

Pjeset e kapitalit nenshkruhen dhe shlyhen nga ortakët ne raportet e meposhtme:


- | | | |
|----|---------------------------|---------------|
| a) | Ortaku Julien Roche | 25 pjese(25%) |
| b) | Ortaku Marsel Skendo | 25 pjese(25%) |
| c) | Ortaku Aleksander Frangaj | 50 pjese(50%) |

Neni 8. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar

Zmadhimi i kapitalit fillestar do te behet me vendim te Asamblese se Ortakeve me ane te kontributeve ne para dhe/ose ne natyre.

Vleresimi i cdo kontributi ne natyre do te behet neprmjet nje raporti qe do te hartohet nen pergjegjesine e tij nga nje ekspert per kontributet i emeruar me vendim te gjykates sipas kerkeses se administartorit.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asamblea e Ortakeve qe merr vendim per kete nese do te votojne "pro" ortakët qe perfagesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne



te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 9. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rast trashegimnie ose ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'i transferohen nje personi te trete qe nuk ben pjese ne shoqëri vetëm në kushtet dhe sipas procedurës së mëposhtme:

Ortaku që dëshiron të transferojë pjesë të kapitalit themeltar tek një person i tretë që nuk bën pjesë në shoqëri duhet më parë t'ia njoftojë projektin e transferimit në formë të shkruar si shoqërisë ashtu edhe sejcilit ortak vecas. Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë jo-pjesmarrës në shoqëri vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që perfaqesojne të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin për transferimin, ortakët, brënda tre muajve nga data e refuzimit te shoqërisë, duhet që t'i blejne vete këto pjesë duke gëzuar të drejtën e parablerjes. Në rast se nuk e përdorin këtë të drejtë ortaket lejojne transferimin e pjesëve tek personi i tretë me të njëjtat kushte si ato të ofruara ortakëve të shoqërisë. Vlera e pjesëve të kapitalit themeltar që do të transfrohen, në rast mosrënieje dakord ndërmjet ortakëve, do të caktohet nga një ekspert i caktuar prej tyre. Kur ata nuk do të merren vesh ndërmjet tyre eksperti caktohet nga Gjykata.

ASAMBLEA E ORTAKEVE


Neni 10. Kompetencat

Asamblea e Ortakëve mund te jete e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Ajo merr vendimet më të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë dhe me politikën ekonomike, komerciale dhe organizative të saj.

1. Asamblea e zakonshme e ortakëve vendos:

- a) për bilancin vjetor të shoqërisë;
- b) për emërimin ose shkarkimin e administratorit;
- c) për strukturën organizative te shoqërisë së revistës apo gazetës si dhe të numrit total të vendeve të punës në to;
- d) për masën e shpërblimit të administratorit të shoqërisë, të drejtorit dhe te kryeredaktorit të revistës apo gazetës;
- e) miratimin e buxhetit vjetor dhe projektet e shoqërisë per te ardhmen;
- f) zgjedhjen e kryetarit të Asamblesë së Ortakëve;
- g) për cdo vendim tjetër që ka lidhje me shoqërinë me perjashtim të atyre çështjeve që me këtë Statut, në bazë të ligjit, u janë lënë në kompetencë organeve të tjera të shoqërisë.

2. Asamblea e jashtëzakonshme vendos:



- a) për ndryshimin Statutit;
- b) për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- c) për prishjen e shoqërisë.

3. Ortaku Aleksander Frangaj caktohet edhe drejtor i revistes dhe do te jete kompetent për percaktimin e struktures profesionale te stafit te redaksise, emërimin ose shkarkimin kryeredaktorit të revistës ose gazetës;

Drejtori I raporton Asamblese per ecurine e revistes dhe i paraqet asaj per miratim Rregulloren e Funkcionimit te Redaksise.

Neni 11. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

Asamblea e zakonshme e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit mbas nje thirrjeje të bërë me shkrim nga Kryetari i Asamblesë që u dërgohet ortakëve të paktën 30 ditë përpara.

Kjo thirrje duhet të dërgohet në adresën e dhënë në Librin e Ortakëve.

Asamblea e Ortakëve ëshërë e vlefshme nga pikpamja konstitutive dhe merr vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë te pakten më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai disponon.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve.


Proces-verbali i mbledhjes së Asamblesë nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i saj të cilët caktohen për cdo mbledhje të Asamblesë.

Vendimet në Asamble merren dhe quhen të vlefshme nëse për to kanë votuar "pro" ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë me përjashtim të çështjeve të mëposhtëme për miratimin e të cilave duhet vota "pro" e të paktën tre të katërtave të pjesëve të kapitalit themeltar sic janë:

- ndryshimet në Statutin e shoqërisë;
- zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- emërimi i drejtorit dhe kryeredaktorit të revistës ao gazetës;
- shpërndarja ose prishja e shoqërisë.

Neni 12. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i vetëm që emërohet nga Asamblea e zakonshme e Ortakëve. Ai mund të mos jetë ortak në shoqëri. Kohëzgjatja e mandatit te administratorit është nje vit dhe mund te rinovohet ne mbarim te fatatit nje vjekar



Administratori mund të shkarkohet para mbarimit të mandatit me vendim të shumices absolute të Asamblese së Ortakëve.

Administrator për vitin e parë financiar emërohet ortaku Aleksander Frangaj.

Neni 13. Kompetencat e Administratorit

Administratori i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që me ligj u janë dhënë shprehimisht ortakëve.

Ai ka të drejta të plota për drejtimin operativ të shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që gëzon Asambleja e Ortakëve në bazë të nenit 9 të këtij Statuti.

Administratori përfaqëson shoqërinë në të gjitha veprimet juridike, financiare si dhe ka të drejtën të veprojë në emër të shoqërisë në organet e ndryshme si ato fiskale, doganore, bankare, gjyqësore etj.

Administratori mbulon edhe veprimtarinë shperndarese të botimeve, marketingun etj.

VEPRIMTARIA EKONOMIKE E SHOQERISE

Neni 14. Ushtrimoret

Ushtrimoret fillojnë normalisht më 1 Janar dhe mbarojnë më 31 Dhjetor të çdo viti.

Perjashtimisht, ushtrimori i parë fillon në datën e themelimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 Dhjetor 1997.


Neni 15. Marrëdhëniet e punesimit

Marredheniet e punes me punemarresit janë kompetence e Administratorit, duke përfshirë edhe të drejtën për të zgjidhur kontratat e punes.

Sidoqofte Asambleja rezervon të drejtën të anullojë vendimin e tij për zgjidhje të kontrates së punes kur konstaton se zgjidhja është bërë pa shkaqe të arsyeshme.

Neni 16. Libri i llogarisë

Shoqëria do të mbajë librat e llogarisë, do të nxjerrë bilancet si dhe do të përlllogarisë fitime dhe humbjet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë të vecantë të ligjit nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin".



Neni 17. Rezerva e domosdoshme

Nga fitimi i realizuar vjetor caktohet një fond rezervë në masën 1/20 e tij që destinohet për formimin e një Fondi Rezerve të quajtur "Rezervë e domosdoshme".

PRISHJA E SHOQERISE

Neni 18. Prishja e shoqërisë

Shoqëria mund të priset në rastet e mëposhtme:

- Kur mbaron afati i caktuar në aktet e themelimit të shoqërisë.
- Kur merret vendim nga Asambleja e Ortakëve sipas nenit 9 të këtij Statuti.
- kur ka humbje të gjysmës së kapitalit themeltar, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 72 të ligjit nr. 7638, datë 19.01.1992 "Për shoqëritë tregtare".
- kur realizimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë behet I pamundur.

Neni 19. Likuidimi

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi themeluesit caktojnë një likuidator që do të paraqesë Raportin e Likuidimit në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.01.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 20. Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet eventuale do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.


Aleksander Frangaj Ortaket themelues

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 1495 REP.
NR. 434 KOL.

V E R T E T I M

Sot, me datë 11 shkurt 1997, para meje noteres Mimoza Sadushi u paraqit personalisht 1. Aleksander Frangaj, shtetas shqiptar, lindur me 4.10.1968, banues ne Lezhe, Lagjja "Beslidhja", Pallati 154, me leternjoftimi NF Nr.138935; 2. Julien Roche, shtetas francez, lindur ne Bourg on Bres me 2 korrik 1954, banues ne Paris, Avenue "Mozart", me pasaporte nr 03/97; 3. Marsel Skendo, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 6 Nentor 1949, banues ne rrugen "Fadil Rada", Pallati 11, Ap.11, Tirane, me pasaporte nr.0165026 "Per Shoqerite Tregtare". Pasi u binda per identitetin e tij nepermjet verifikimit te dokumenteve personale te identifikimit, vertetoj nenshkrimin e tij ne perputhje me kerkesat e ligjit.



MIMOZA SADUSHI
NOTERE
sa: Pallatet e Lanës, 1
e Fax -- 355 42 23866
TIRANË ALBANIA

NOTEREA